



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Sintaksë e Gjuhës B

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione / 20 seminare
Viti / Semestri : Viti II , semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor – *Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian*
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Ky kurs synon të paraqesë një hyrje në teoritë themeloretësintaksës, lidhjet e saj me disiplinat e tjera gjuhësore, konceptet themelore të strukturës gramatikore, lidhjet gramatikore mes fjalëve dhe funksionet e tyre brenda fjalisë, bashkimit të fjalëve në togfjalësja, të togfjalëshave në fjali e të fjalive në periudhë sipas marrëdhënieve të tyre kuptimore apo formave gramatikore që shfaqen gjatë ligjërimit. Përdorimi dhe zbatimi në praktikë i disa prej modeleve të analizës sintaksore do t'i volisë së tepërmi procesit të mësimdhënies dhe atij të përkthimit, në kontekste shkollore apo profesionale.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Të identifikojë dhe analizojë në mënyrë të detajuar të gjitha konceptet themelore dhe strukturat gjuhësore sintaksore të gjuhës italiane.
- 2.Të dallojë gjymtyrët kryesore të fjalisë: kryefjalë dhe kallëzues; gjymtyrët e dyta të saj: kundrinor, rrethanor, përcaktor etj. dhe pjesët e ligjëratës me të cilat shprehen ato;
3. Të dallojë tipat e fjalive sipas llojit të kumtit që ato shprehin, si fjalia dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore, habitore etj.;
- 4.Të dallojë marrëdhëniet e bashkërenditjes dhe të nënrenditjes në kontekstin e fjalisë së përbërë dhe lidhëzat përkatëse të cilat shprehin këtë lloj marrëdhënieje;
- 5.Të dallojë ligjëratën e drejtë dhe ligjëratën e zhdrejtë si edhe të përvetësojë rregullat gramatikore të kalimit nga njëra tek tjetra.

Rezultatet e pritshme:

Në fund të këtij kursi studenti do të jetë i aftë të asimilojë konceptet kryesore të shkollave të ndryshme gjuhësore mbi sintaksën dhe evolucionin e kësaj discipline; të punojë me fjalën, togfjalëshin, fjalinë dhe periudhën duke analizuar marrëdhëniet që ekzistojnë mes tyre;